



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
KANCELARI**

Nr. 2606 Prot

Tiranë, më 04.10.2023

NJOFTIM PËR SHPALLJE

PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE

Bazuar në ligjin nr. 98/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil”, vendimin e KLGJ-së nr. 148, datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”, vendimin nr. 6, datë 07.07.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe vendimin nr. 10, datë 11.09.2023, të Këshillit të Gjykatës, **GJKKO-ja shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor** për pozicionin si më poshtë:

1 (një) pozicion - Shef Sektori, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kategoria e ulët drejtuese, III-1.

Pozicioni më sipër, iu ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën lëvizjes paralele. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për

Lëvizje paralele - 18.10.2023

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për

Ngritje në detyrë - 25.10.2023

Afati i dorëzimit të dokumentacionit për

Pranim në shërbimin civil gjyqësor - 25.10.2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- a) Menaxhon punën e sektorit;
- b) Koordinon dhe ndan detyrat në sektor;
- c) Menaxhon punën për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- d) Menaxhon punën, ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës;
- e) Kontrollon shkallën e zbatimit të parimeve të cilësisë statistikore, si dhe harton raporte të veçanta dhe periodike të cilësisë për çdo tregues dhe/ose aktivitet statistikor të parashikuar;
- f) Mbikëqyr grumbullimin, përpunimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore dhe për metodikën dhe mënyrën e mbajtjes së statistikës gjyqësore;
- g) Mirëmbajtjen dhe kontrollin e sistemit kompjuterik, elektronik, të teknologjisë së informacionit, si dhe për ruajtjen dhe përpunimin e statistikave të gjykatës;
- h) Ndihmon Kancelarin në procesin e rekrutimit të punonjësve të tjerë të gjykatës sipas ligjit, duke përgatitur të gjitha dokumentet dhe aktet e nevojshme për këtë qëllim;
- i) Merr masa për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
- j) Kontrollon përdorimin me korrektësi të pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
- k) Kujdeset për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- l) Kujdeset që shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë;
- m) Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme;
- n) Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun;
- o) Kryen detyra të tjera, sipas urdhrave apo porosive të Kryetarit, Kancelarit apo Këshillit të Gjykatës;
- p) Menaxhon punën për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

- q) Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme;
- r) Ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës;
- s) Mbikëqyr dhe menaxhon në mënyrë efektive organizimin, drejtimin, kontrollin, disiplinën;
- t) Shpërndan punën në sektor me qëllim që të sigurohet cilësia dhe sasia, realizimin në kohë dhe rezultatet e matshme, lidhur me objektivat e planifikuara;
- u) Vlerëson aftësinë dhe performancën e personelit;
- v) Informon në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura, për risqet dhe defektet në veprimtarinë e strukturës që drejton;
- w) Punon brenda procedurave dhe orientimeve të përcaktuara të Kancelarit;
- x) Siguron kontributin në vendimmarrje nëpërmjet përgatitjes së të dhënave analizuese të plota, që mbështesin linjën e rekomanduar të veprimit.

1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit gjyqësor.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

a-	Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-1.
b-	Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
c-	Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi: Diplomë e nivelit “Master Shkencor” në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Juridike;

Përvoja: Të ketë kryer të paktën 3 vjet praktikë profesionale.

Aftësi të tjera: Të zotërojë gjuhë të huaj – preferencë për gjuhët e BE-se;

Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide, mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

- Të plotësojë të gjitha kushtet e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, sipas nenit 57, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- Të japin pëlqimin për plotësimin e kushteve të sigurisë të përcaktuar në ligjin nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe në nenin 41 të Vendimit të KLGJ-së, nr. 622 datë 10.12.2020.

Kushtet e sigurisë para emërimit në detyrë janë:

- kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës;
- dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake;
- si dhe dhënia e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë protokollit të GJKKO-së brenda datës **18.10.2023**, dokumentet si më poshtë vijon:

- Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta>.
- Kërkesë motivimi për aplikim për vendin e lirë të punës.
- Fotokopje e diplomës dhe të listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal.
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
- Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit si drejtues i nivelit të ulët.
- Formularët e Deklarimit të Pasurisë, si dhe formularët A, B2, B3 të përcaktuar në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, (me anë të të cilave jep pëlqimin për kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, si dhe dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake).

(Formularët gjenden të publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi).

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në zyrën e Protokollit, të GJKKO-së, brenda datës **18.10.2023**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **19.10.2023**, Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të GJKKO-së, si dhe në këndin e afishimeve të njoftimeve për publikun, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a-	Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
b-	Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.
c-	Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
ç-	Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.
d-	Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
e-	Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
f-	Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), si më poshtë:

- 40 (dyzet) pikë** për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
- 50 (pesëdhjetë) pikë** për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- 10 (dhjetë) pikë** për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

Kandidati që merr më pak se **70 (shtatëdhjetë) pikë** nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë maksimale, për t'u

emëruar në vendin e lirë.

1.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari i Gjykatës, do të njoftojë për fituesin e shpallur nga Këshilli i Gjykatës në faqen zyrtare www.gjp.gov.al brenda datës 02.11.2023. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ka ende pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të GJKKO-së, duke filluar nga data **24.10.2023**. Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët e institucioneve, të cilat janë pjesë e shërbimit gjyqësor dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas neneve 9, 57, etj, të ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidati në procedurë “Ngritjes në detyrë” janë të njëjta me ato të “Lëvizjes paralele”.

2.1 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet, deri më datë **25.10.2023**, si më poshtë vijon:

- a) Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhëzime-dokumenta/219-udhëzime-dokumenta>.
- b) Kërkesë motivimi për aplikim për vendin e lirë të punës.
- c) Fotokopje e diplomës dhe të listës së notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d) Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë).
- e) Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f) Vërtetimin e gjendjes shëndetësore.
- g) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- h) Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal.
- i) Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.
- j) Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- k) Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- m) Aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit si drejtues i nivelit të ulët.
- n) Formularët e Deklarimit të Pasurisë, si dhe formularët A, B2, B3 të përcaktuar në

ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, (me anë të të cilave jep pëlqimin për kontrollin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, si dhe dhënien e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake).
(Formularët gjenden të publikuar bashkëlidhur këtij njoftimi).

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

2.2 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **26.10.2023**, Kancelari, do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të GJKKO-së, www.gjp.gov.al në rubrikën e njoftimeve për publikun, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta me procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe **datën, vendin dhe orën** e saktë ku do të zhvillohet testimi i kandidatit.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e pranimit të ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail ose me celular).

Këshilli, brenda 2(dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin e kandidatëve dhe zhvillon një intervistë të strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind).

Vlerësimi i kandidatëve përfshin:

- a. 70 (shtatëdhjetë) pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, që konsiston në vlerësimin e rezultateve të punës, përvojës profesionale dhe trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse,
- b. 30 (tridhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Pikët për dokumentet e paraqitura dhe për intervistën me gojë, mblidhen. Kandidati që merr më pak se **70 pikë** nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë maksimale, për t’u emëruar në vendin e lirë.

2.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË TESTOHET KANDIDATI

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a- Njohuritë dhe aftësitë në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme të punës.
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.4 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari i GJKKO-së, do të njoftojë për fituesin e shpallur nga Këshilli i Gjykatës në faqen zyrtare www.gjp.gov.al, në rubrikën e njoftimit për publikun, brenda **datës 08.11.2023**. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

3. PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë rezulton se pozicioni i shpallur është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të GJKKO-së, duke filluar nga **data 30.10.2023**.

Kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta që duhet të plotësojnë kandidati në procedurën e “*Pranimit në shërbimin civil gjyqësor*” janë të njëjta me procedurën e “*Lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë*”. Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët e institucioneve, të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil gjyqësor dhe që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas ligjit 98/2016 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*” dhe ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë drejtuese, do të marrin informacion në faqen e GJKKO-së dhe të KLGJ-së, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë drejtuese:

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**
- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. **60 (gjashtëdhjetë) pikë** për vlerësimin me shkrim.
- b. **40 (dyzet) pikë** për vlerësimin nga Këshilli.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË

PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Rr. “Jordan Misja”, Nr.1, Tiranë, Telefon 042231527, tel/fax 042225075, e-mail sekretaria@gjp.gov.al

Rr. “Jordan Misja”, Nr.1, 1057 Tiranë, Tel/fax 042225075, www.gjp.gov.al

